



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Nr. ____prot.

Tiranë, më. ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
TE KONTRATES PER 3 MUAJ
ME OBJEKT PROKURIMI “PLEHRA KIMIKE,FURNITURA VETERINARE,FARERA
FIDANE E TE TJERA PRODUKTE”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “PLEHRA KIMIKE,FURNITURA VETERINARE,FARERA
FIDANE E TE TJERA PRODUKTE” NDARË NË 2 (dy) LOTE bazuar ne nenin 39 te Ligjit
162/2020 “Per Prokurimin Publik” si vijon:**

- **Loti I.** “Furnitura veterinare,farera,fidane e te tjera produkte”, me afat të kontrates 3 (tre) muaj.
- **Për Lotin II.** “Plehra Kimike”, me afat të kontrates 3 (tre) muaj”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)
0310000-2, (03111000-2) (03121100-6).

Vlera e Fondit Limit Total eshte: 18 333 299 (tetëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tremijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH ose 182 875.8 (njëqind e tetëdhjetë e dymijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pik tetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 05.08.2024) e ndarë në 2 lote si më poshtë:

- **Loti I.** “Furnitura veterinare,farera,fidane e te tjera produkte”, me afat të kontrates 3 (tre) muaj, me fond limit: **17 898 670** (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) **lekë pa TVSH ose 178 540.35** (njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet pik tridhjetë e pesë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 05.08.2024).
- **Loti II.** “Plehra Kimike”, me afat të kontrates 3 (tre) muaj, me fond limit: **434 629** (katërqind e tridhjetë e katërmijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) **lekë pa TVSH ose 4 335.45** (katërmijë e treqind e tridhjetë e pesë pik dyzet e pesë) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 05.08.2024).

I mbajtur sot më date **05.08.2024** në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, , për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur mbi kufirin e larte monetar» , me mjete elektronike, duke gjetur zbatim referuar nenit 42 pika 4 e Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik dhe neneve 40, e VKM 285 date 19.05.2021 «Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik» , me afat 3 mujor nga data e lidhjes se kontrates.

Sasia për **Loti I. “Furnitura veterinare,farera,fidane e te tjera produkte”** si dhe grafiku i ekzekutimit;

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Afati I ekzekutimit
1	Tulipan	copë	2000	DPPGJ	3 muaj
2	Lule Zjarri	copë	10400	DPPGJ	3 muaj
3	Mullagë Varëse	copë	2000	DPPGJ	3 muaj
4	Petunjë	copë	4000	DPPGJ	3 muaj
5	Begonje	copë	13600	DPPGJ	3 muaj
6	Viola	copë	10400	DPPGJ	3 muaj
7	Ciklamin	copë	14400	DPPGJ	3 muaj
8	Trëndafila	copë	600	DPPGJ	3 muaj
9	Farë bari	kg	500	DPPGJ	3 muaj

Sasia për **Loti II. “Plehra Kimike”**, si dhe grafiku i ekzekutimit;

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Afati I ekzekutimit
1	Ushqyes kimik (mikroelemente)	kv	13	DPPGJ	3 muaj
2	Klerad	liter	7	DPPGJ	3 muaj
3	ACTELLIC 50 EC (Insecticid)	liter	7	DPPGJ	3 muaj
4	MATCH 050 EC (Insecticid)	kg	7	DPPGJ	3 muaj
5	ENOVIT METHYL (Fungicid)	kg	7	DPPGJ	3 muaj
6	Defend WD (Fungicid)	kg	7	DPPGJ	3 muaj
7	STOMP AQUA (Herbicid)	kg	13	DPPGJ	3 muaj
8	Sevim	liter	13	DPPGJ	3 muaj
9	Terminator	kg	7	DPPGJ	3 muaj

Per objektin ne reference.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, DPPGJ, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Shtojca 7

Loti I. “FURNITURA VETERINARE,FARERA,FIDANE E TE TJERA PRODUKTE”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike , grafikun e lëvrimit të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1 dhe pika 2 germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të të ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin'.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

*"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 299 Prot date 15.05.2024, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i një prej kriterit të mësipërm e bën ofertën e kualifikueshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet paraqesë Çertifikatë zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe çertifikatë origjine të lëshuara nga Enti Shtetror i Farnave e Fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e çertifikimit të matrialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative)ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe

certifikate origjine te leshuara nga Enti Shtetëror i Farnave e Fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e çertifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative).

Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë furnizimi nga subjekti importues, ku të jetë pajisur me këto dokumenta:

- Çertifikatë Origjine.
- Çertifikate Fitosanitare
- Varietetet të jenë të regjistruara në katalogun kombëtar shqiptar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e çertifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe bazuar në aktin nënligjor normativ të nxjerrë në bazë të Ligjit 10416, ku në pikën II, “KËRKESAT PËR TREGËTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE”, gërma ”d” të VKM 523 përcaktohet se: “1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi”.

Gjithashtu, nga komunikimet zyrtare në kohë që kemi patur me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, me shkresën nr. 421 prot., datë 16.01.2020 rezulton se dokumentacioni shoqërues që duhet të kenë fidanët e bimëve zbukuruese, drurë apo shkurre dekorative, për t’u tregëtuar, është: 1) Të jenë të çertifikuar nga Autoriteti Çertifikues (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve) duke i pajisur me “ÇERTIFIKATËN ZYRTARE” model 3, aneksi 4 i VKM nr. 523, datë 13.07.2016 ; 2) Të jenë të “AUTORIZUAR” nga Organi Çertifikues (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve) për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit. Autorizimi nxirret sipas modelit 4 të aneksit 4, të VKM nr. 523, datë 13.07.2016.; 3) të kenë “ÇERTIFIKATË ORIGJINE”, që nxirret dhe plotësohet nga furnizuesi dhe që ka vlerë pasi nënshkruhet dhe vulozet nga Autoriteti Çertifikues”.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij per periudhen e kerkuar:

- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 2(dy) Inxhinier Agronom

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin diplome, kontratat e punës (te vlefshme brenda afatit të vlefshmerisë së ofertës), cv, dhe libreze pune.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin'.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës" dhe nenit 40, pika 5 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" .

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Inxhinier mjedisit dhe 2(dy) inxhinier Agronom lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga keto inxhinierë.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën **15 personave**, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muajt; për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.
- List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin'.

Argumentimi: Kërkesa e AK është e bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Bazuar në 'Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë' si dhe 'Vendim Nr. 1025, Datë 16.12.2020 Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi'.

Numri I punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë

tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sakohë që ato janë në për pjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues I kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome, dëshmi / certifikatët rajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si mëposhtë:

- 2 (dy) specialist ekspert mjedisi i pajisur me certifikate Vleresim Ndikimi në Mjedis, diplome, cv, kontrate pune.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin'.

Argumentimi: Kërkesa e AK është e bazuar në në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5 a,b,c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Kërkesat e mesiperme janë të mbështetura në zërat e punimeve që janë parashikuara në preventiv si edhe në krijimin e besueshmërisë së AK në zotërimin e kualifikimeve të nevojshme për të zbatuar kontratën ku autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për personelin kryesor që ka në dispozicion OE, duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësitë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës për të krijuar besueshmëri publike nga OE për realizimin me efikasitet dhe efikasitet të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat si mëposhtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 9001 – 2015** ose **ekuivalent**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme). (Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili OE).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 14001 – 2015** ose **ekuivalent**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme). (Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili OE).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 45001-2018** ose **ekuivalent**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastin e bashkimit të operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili OE).

Shënim: Certifikatat e mesiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar

ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 40, pika 8 dhe 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot, date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të kontrates.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit (e vlefshme):

- a. Licencë, Kodi III.7.A për ”Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotat ”QKL”.
- b) Licence, Kodi II.4. për ”Prodhimi dhe/ose tregtimi i farnave dhe/ose fidaneve”

